



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM**  
**“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TË**  
**TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE PRIVATE”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 133, datë 04.12.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënie të licencave të transmetimit audio analoge private”, **në muajin janar 2021**, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 1 licence private të transmetimit audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimit të rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Bashkia Elbasan, Cërrik, Belsh	Audio Analoge Lokale	Petresh	89.1

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë private të transmetimit audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, ***brenda datës 21 janar 2021, ora 10.00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidatave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio”, e ndryshuar;
- Kushtet teknike të instalimit të pajisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit);
- Kërkesat programore;
- Pagesat për licencën, taksat etj, të llogaritura për zonën në fjalë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datën 21 janar 2021, ora 10.00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.